

Një grup i të rinjve, anëtarë të Rinisë Demokratike të Kosovës – dega në Prishtinë zhvilluan një takim me kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiun Naim Tërnavë.

Sipas një njoftimi, në takim u diskutua për zhvillimet aktuale në vendin tonë me ç'rast u prek edhe akti simbolik i djegies së logos që përdoret nga grupi ISIS.

“Të rinjtë shpjeguan në takim me Myftiun Tërnavë se aktiviteti i djeshëm simbolik nuk kishte qëllim të ofendimit të ndjenjave fetare të besimtarëve mysliman në Kosovë dhe as thëniet e shenjta për islamin. Qëllimi, u tha nga të rinjtë në takim, ishte ta kundërshtojnë terrorin dhe aktet terroriste të grupit ISIS me veprimet e tyre kriminale në rend të parë kundër fëmijëve dhe grave që i bëjnë në kundërshtim me parimet e fesë islame”, thuhet në njoftim.

Me këtë rast shtohet se myftiu Tërnavë theksoi se të rinjtë tanë duhet të jenë të kujdesshëm e të matur në veprimet e tyre dhe mos të bien pre e fushatave që më shumë mund të sjellin debate, konfuzion e paqartësi se sa qëllimi i tyre për distancim nga veprimet e ISIS.

“Po ashtu, në takim Myftiu tha se ne si popull solidarizohemi me vuajtjet e popullatës civile në Irak e Siri, dhe në të njëjtën kohë dënojmë veprimet kriminale të asaj që quhet ISIS. “Të rinjtë theksuan se Rinia Demokratike e Kosovës ka një orientim të qartë demokratik, vlerave të tolerancës dhe mirëkuptimit ndërfetar e ndërnjerëzor”, përfundohet në njoftimin e PDK-së. /Telegrafi/